



**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republik of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva**

Nr.06-334/07-0101709/22

Dt. 13.12.2022

Bazuar në Nenet 67, 68 të Ligjit Nr. 06/L – 114 për Zyrtarët Publik të Republikës së Kosovës, Nenet 8 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës, në mbështetje të Udhëzimit Administrativ Nr. 07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, si dhe në bazë të kërkesës së QKMF-së me nr.1678, Komuna e Podujevës shpall:

KONKURS PËR PLOTËSIMIN E VENDEVE TË LIRA TË PUNËS

DREJTORIA E SHËNDETËSISË DHE MIRËQENIES SOCIALE

QENDRA KRYESORE E MJEKËSISË FAMILJARE

I. Pozita: Doktor i Stomatologjisë - 1 (një) pozitë

Koeficienti: Koef - 7.2/ H-26

Lloji i vendit të punës: Me afat të pacaktuar, me orar të plotë (Periudha provuese 6 (gjashtë) muaj.

Përshkrimi i detyrave të punës:

1. Ofron shërbime stomatologjike;
2. Avancoon dhe promovon shëndetin oral;
3. Kujdeset për mjetet e punës ;
4. I përmbahet etikës mjekësore;
5. Kryen plotësimin adekuat të dokumentacionit;
6. Bashkëpunon me ekipet e mjekësisë familjare dhe strukturat tjera relevante në përmirësimin e kujdesit oral;
7. I ndihmon shefit të sektorit të shëndetit oral;
8. Për punën e vet i përgjigjet shefit të sektorit oral dhe Drejtorit të QKMF-së.

Kualifikimi i kërkuara:

- Diploma e Fakultetit të Mjekësisë - Drejtimi Stomatologji
- Licencë përkatëse të lëshuar nga organi kompetent.

II. Pozita: Farmacist/e i diplomuar - Master i farmacisë në QKMF Podujevë, 1(një) pozitë

Koeficienti: Koef - 7.2/ H-30

Lloji i vendit të punës: Me afat të pacaktuar, me orar të plotë (Periudha provuese 6 muaj)

Përshkrimi i detyrave të punës:

1. Organizon, koordinon dhe mbikqyrë punët në depo dhe farmaci;
2. Kontrollon preparatet dhe barërat që gjenden në depo, afatet dhe llojet e barërave;
3. Mbikqyrë punën e infermierit/es farmaceutike;
4. Në bashkëpunim me kryeinfermierin e QKMF-së i propozon asgjësimin e barërave dhe preparateve me afat të skaduar;
5. Kryen edhe punë tjera të parapra me ligj;
6. Për punën e vet i përgjigjet Drejtorit.

Kualifikimi i kërkuara:

- Diploma e Fakultetit të Mjekësisë - Drejtimi Farmaci;
- Licencë përkatëse të lëshuar nga organi kompetent.

III.Pozita: Mjek i Përgjithshëm në QKMF Podujevë, 3 (tri) pozita

Koeficienti: H-20

Lloji i vendit të punës: Me afat të pacaktuar, me orar të plotë (Periudha provuese 6 muaj)

Përshkrimi i detyrave të punës:

- Ofron mbrojtjen primare shëndetësore për pacientin dhe familjen;
- Pranon pacientin nga Infermierja, shkruan të dhënat në kartelën shëndetësore, merr anamnezën, bënë ekzaminimin e pacientit (inspektimin, auskultimin, palpacionin dhe perkusionin), reanimimin kardio pulmonar dhe referon pacientin për hulumtime të tjera dijagnostike;
- Bën diagnozën initiale dhe trajtimin me terapi adekuate;
- Udhëzon tek specialisti konsultant nëse është e nevojshme konsulta;
- Kryen shërbime në kuadër të shëndetit reproduktiv, kujdesit antenatal dhe postnatal;
- Bën imunizimin (vaksinimin);
- Promovon edukimin shëndetsor;
- Trajton lëndime të vogla;
- Kryen vizita shtëpiake kur është e domosdoshme;
- Bën identifikimin e grupeve vulnerable dhe të rrezikuara;
- Bën dhënjen e barërave dhe medikamenteve esenciale;
- Gjatë punës së tij i asistojnë infermierët;
- Për punën e vet i përgjigjet Kryeshefit të DMF dhe Drejtorit.

Kualifikimi i kërkuara:

- Diploma e Fakultetit të Mjekësisë - Drejtimi i Përgjithshëm;
- Licencë përkatëse të lëshuar nga organi kompetent.

IV. Pozita: Infermier/e i Përgjithshëm- 2 (dy) pozita**Koeficienti: H - 377/1****Lloji i vendit të punës: Me afat të pacaktuar, me orar të plotë (Periodha provuese 6 (gjashtë) muaj).****Përshkrimi i detyrave të punës:**

- Pranon, triazhon dhe informon pacientin, hap kartelën shëndetësore, merr anamnezën e shkurtër orjentuese, kryen participimin, matë gjatësinë, peshën trupore, temperaturën, tensionin arterial, reanimimin kardiopulmonar, bën EKG, problemet geriatrike, aplikon terapinë parenteriale, IM, IV, subkutan, infuzion, inhalimin, përpunimin e plagës, këshillon pacientin, dhe udhëzon te mjeku familjar;
- Në bashkëpunim me mjekun familjar ofron mbrojtjen primare shëndetësore për pacientin dhe familjen;
- Promovon edukimin shëndetësor;
- Trajton lëndimet - plagët para dhe post operative;
- Jep ndihmën shëndetësore në Institucion dhe vendin e ngjarjes;
- Kryen vizita shtëpiake kur është e domosdoshme me udhëzim të mjekut;
- Bën injektimin e të gjitha mënyrave të mundshme (IM, IV, SC, ID etj);
- Kryen të gjitha punët administrative në lidhje me shërbimet që i bën;
- Kryen edhe punë tjera sipas udhëzimit të mjekut;
- Bën transportimin e pacienteve të sëmurë nga QKMF deri ne institucionin më të avansuar(SHSKUK) në bazë të udhëzimit të mjekut ordinar, e në raste urgjente edhe pa udhëzim por me arsyetim të mëvonshëm;
- Për punën e vet i përgjigjet shefit të shërbimit dhe Drejtorit.

Kualifikimi i kërkuara:

- Diplomë e Shkollës së Mesme të Mjekësisë apo Diplomë e Fakultetit të Infermierisë
- Licencë përkatëse të lëshuar nga organi kompetent.

V. Pozita: Infermier/e - Mami 1 (një) pozitë

Koeficienti: H - 377 / 1

Lloji i vendit të punës: Me afat të pacaktuar, me orar të plotë (Periudha provuese 6 (gjashtë) muaj.

Përshkrimi i detyrave të punës:

- Bën pranimin e gruas në sallën e lindjes
- Përgatitjen e materialit, mjetet për lindje, kompresat, tuferat dhe gjërat tjera të nevojshme;
- Kujdeset për dhënien e terapisë;
- I asiston mjekut gjatë lindjes së gruas, ose udhëheqjen e lindjes në mungesë të mjekut (ekip dhe e pavarur);
- Bën qepjen e rrupturave të shkallës së parë dhe të dytë;
- Bën Pastrimin dhe sterilizimin e mjeteve të punës dhe materialit të nevojshëm;
- Këshillimin e grave për planifikimin e familjes dhe kujdesin për të porsalindurin;
- Në rast nevojë kryerjen edhe të punëve tjera në kuadër të kualifikimit me urdhër të eprorit;
- Për punën e vet është përgjegjës para Shefit të shërbimit dhe Drejtorit.

Kualifikimi i kërkuara:

-Diplomë e Shkollës së Mesme të Mjekësisë drejtimi Mami apo Diplomë e Fakultetit të Infermierisë drejtimi Mami

-Licencë përkatëse të lëshuar nga organi kompetent.

VI. Pozita: Asistent/e i stomatologjisë 1 (një) pozitë

Koeficienti: H - 377 / 1

Lloji i vendit të punës: Me afat të pacaktuar, me orar të plotë (Periudha provuese 6 (gjashtë) muaj.

Përshkrimi i detyrave të punës:

- Kryen të gjitha punët nga fushëveprimi i asistentit stomatologjik;
- Vendos kontaktin e parë me pacientin, e kontrollon rregullsinë e dokumentacionit, evidenton të dhënat e nevojshme dhe të dhënat tjera mjekësore - statistikore;
- E përgatitë e mirëmban aparaturën stomatologjike, instrumentet, barërat dhe mjetet ndihmëse të tjera për punë, bën dezinfektimin dhe sterilizimin e instrumenteve dhe aparateve në vendin e punës;
- Bashkëpunon me stomatologun dhe i ndihmon në të gjitha ndërmarrjet stomatologjike, koordinon punën dhe bashkëpunon me teknikët e fazave punuese laboratorike dhe bërjen e mjeteve ndihmëse të dhëmbëve, procesorëve;

- I udhëzon pacientët për vizita të mëtejme dhe në punët e edukimit shëndetësor në kuadër të përgatitjes së vet profesionale duke pasur parasysh udhëzimet para dhe pas ndërmarrjeve të bëra stomatologjike;
- Sipas udhëzimeve të mjekut stomatolog jep pemedikacione ose pas ndërmarrjes të bëra jep medikamente;
- Kujdeset për komunikimin racional të barërave ditore të shërbimit dhe nxjerr raporte mujore, harton kërkesën e barërave të nevojshme për nevoja të shërbimit.
- Organizon dërgimin dhe pranimin e ndërresave, të rrobave mbrojtëse dhe mbikëqyrë pastërtinë në vendin e punës në bashkëpunim me higjienistët.
- Kryen edhe punë të tjera sipas urdhërit të stomatologut apo Shefit.

Kualifikimi i kërkuara:

- Diplomë e Shkollës së Mesme të Mjekësisë drejtimi Stomatologji
- Licencë përkatëse të lëshuar nga organi kompetent.

INFORMATË E PËRGJITHSHME PËR TË GJITHË KANDIDATËT

Kërkesat e përgjithshme për pranim:

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të zotërojë njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
- Të jetë i aftë në pikëpamje shëndetësore për të kryer detyrën përkatëse;
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje;
- Të mos ketë në fuqi një masë disiplinore për largim nga një pozitë e zyrtarit publik, të pushuar sipas këtij ligji.

Dokumentet e Kërkuara:

- Diploma e kualifikimit përkatës;
- Dëshmia e Licencës;
- Kopja e Leterënjoftimit;
- Çdo dokument tjetër apo certifikatë trajnimi;
- Certifikatën që nuk jeni nën hetime;
- Certifikatën shëndetësore të lëshuar nga një institucion publik shëndetësor që dëshmon se gjendja e kandidatit është pa probleme shëndetësore (Kjo dëshmi sillet pas pranimin në mardhënje pune të kandidatit);
- Dokumentet i dërgoni fotokopje sepse të njëjtat nuk kthehen.

AFATI I APLIKIMIT:

Data e njoftimit në webfaqen unike të procedurave të konkurimit <https://konkursi.rks-gov.net> është prej dt.13.12.2022 deri me dt.11.01.2023

Afati për paraqitjen e aplikacioneve është 15 ditë, nga data 12.01.2023 deri me datën 26.01.2023.

Përveç web faqes unike të procedurave të konkurimit, konkursi publikohet edhe në web-faqe zyrtare të Komunës.

Komuna e Podujevës ofron mundësi të barabarta punësimi për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë.

Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen.

Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.

Fletëaplikacionet merren në Qendrën e Shërbimit për Qytetarë, në ndërtesën e Kuvendit të Komunës.

Kërkesat me dokumente të kompletuara dorëzohen në Qendrën e Shërbimit për Qytetarë.

Për çdo informatë plotësuese mund të kontaktoni në Drejtorinë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, në këtë numër të telefonit 038 200 41-005.

Rezultatet shpallen në linkun: <https://konkursi.rks-gov.net/>